



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të dates 4 Qershor 2008, neneve 9 pika f) dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

**URDHËRESE
MBI NDALIMIN E PËRDORIMIT TË UJIT NGA UJËSJELLËSIT
PËR AKTIVITETE TË CAKTUARA**

Neni 1

Gjatë periodës 15 Korrik deri me 15 Tetor 2015, ndalohet përdorimi i ujit të pijshëm nga ujësjellësit në territorin e Komunës së Lipjanit nga personat fizik dhe juridik, për aktivitetet si vijon:

- a) larjen e automjeteve
- b) larjen e rrugëve private në afërsi të objekteve të banimit dhe të bizneseve
- c) larjen e trotuareve dhe vendeve publike në afërsi të bizneseve dhe objekteve të banimit
- d) larjen e shkallëve dhe hapësirave të objekteve të banimit dhe të bizneseve
- e) ujitjen e bimëve dhe kopshteve
- f) ujitjen e kulturave bujqësore

Neni 2

Përfshirë nga ndalimet e cekura bëjnë subjektet e biznesit të cilat ushtrojnë veprimtaritë e regjistruara të aktiviteteve të cekura në nenin paraprak.

Neni 3

Me gjobë prej 50 (pesëdhjetë) euro, do të gjobiten personat fizik, ndërsa personat që zhvillojnë aktivitete të biznesit me gjobë prej 100 (njëqind) deri 300 (treqind) euro, nëse përdorin ujin nga ujësjellësit për aktivitetet e ndalura nga neni 1 i kësaj Urdhërese.

Neni 4

Për zbatimin e kësaj Urdhërese do të kujdeset Drejtorati i Inspeksionit – Inspektori i Ambientit.

Neni 5

Kjo Urdhëresë hyn në fuqi me 15 Korrik 2015 dhe do të publikohet në WebFaqën e Komunës, në tabelen e shpalljeve të Kuvendit të Komunës dhe në vendet e frekuentuara në qytetin e Lipjanit dhe në vendbanimet e Komunës.

1Nr. 352-33925
Lipjan, më 14.07.2015

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

